



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1261 Prot.

Tiranë, më 16.06 .2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 46 Datë 16.06 2026

**“PËR
PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT "BACHELOR" NË
"AKTIVITETE NË NATYRË DHE TURIZËM SPORTIV", ME DIPLOMË TË DYFISHTË,
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË
VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT DHE ESCOLA SUPERIOR DE
DESPORTO DE RIO MAIOR, INSTITUTO POLITECNICO DE SANTAREM,
PORTUGALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimin nr.310 datë 11.05.2022 "Per specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, në shkresën nr. 824/4 prot., datë 12.06.2026 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit "Propozim për kodifikimin e programit të dyfishtë të studimit "Bachelor" në "Aktivitete në natyrë dhe turizëm sportiv", shkresën e Ministrisë së Arsimit nr. 4516 prot., datë 11.06.2026 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 91, datë 16.06.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 16.06.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët "Bachelor" në "Aktivitete në natyrë dhe turizëm sportiv", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Escola Superior de Desporto de Rio Maior, Instituto Politecnico de Santarem, Portugali.
2. Efektet financiare që burojnë nga kjo marrëveshje do të miratohen në buxhetin e cdo viti.

3. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
4. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P63BA0988A (shkresa bashkëlidhur)
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

